



Funded by
the European Union



RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR MONITORIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE NË 14 BASHKI TË VENDIT

25 PRILL 2021

KJO QENDËR
VOTIMI
MONITOROHET
ME KAMERA

MBANI DISTANCEN
1.5 Meter





Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT PËRFUNDIMTAR
PËR MONITORIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE NË 14
BASHKI TË VENDIT
25 PRILL 2021

Tiranë, Qershor 2021

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në partneritet me Civil Rights Defenders dhe Instituti i Studimeve Politike, mbështetur financiarisht nga Bashkimi European, si dhe iniciativës “Drejt integritetit më të mirë të kandidatëve, për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme në 5 Bashki të vendit” zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga Republika Federale Gjermane. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European dhe të Republikës Federale Gjermane.

Përmbajtja e Raportit:

Hyrja	3
1. Përmbledhje Ekzekutive	3
2. Kuadri ligjor	6
3. Monitorimi parazgjedhor i Zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021	7
3.1. Ngritja dhe funksionimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)	7
3.2. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat e zgjedhësve	8
3.3. Njoftimi i zgjedhësve me shkrim në banesë	8
3.4. Votimi i shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit	9
3.5. Shpërdorimi i burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve	9
3.6. Regjistrimi i partive dhe i koalicioneve	11
3.6.1. Paraqitja e listave shumë-emërore të kandidatëve	11
3.7. Përmbajtja e fletës së votimit	12
4. Ngritja e infrastrukturës së administratës zgjedhore në nivel vendor: KZAZ, KQV dhe GNV	13
4.1. Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve	13
4.2. Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve	13
4.3. Ngritja e GNV-ve	14
5. Fushata zgjedhore dhe incidentet	14
6. Monitorimi i procesit të votimit	15
7. Monitorimi i procesit të numërimit të votave	17
8. Rezultati paraprak i zgjedhjeve dhe ankesat	18
9. Sugjerime dhe Rekomandime	19

Hyrja

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse dhe e pavarur. Misioni i saj qysh në kohën kur ajo është krijuar (16 dhjetor 1990) ka qënë dhe vazhdon të jetë: respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut.

KShH, në zbatim të këtij misioni, ka vlerësuar në mënyrë të veçantë rëndësinë e zgjedhjeve periodike që janë zhvilluar në vendin tonë dhe i ka monitoruar ato qysh nga zgjedhjet parlamentare të vitit 1996, duke dhënë kështu kontributin e tij modest, me qëllim që ato të arrijnë standartet e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Kontributi i KShH-së nuk ka munguar dhe në përmirësimin e legjislacionit zgjedhor, mbështetur sidomos në Raportet e monitorimit dhe Rekomandimet e OSBE/ODIHR-it për Shqipërinë.

Në këtë vështrim dhe për këtë qëllim, KShH u angazhua në monitorimin e zgjedhjeve për Kuvendin, të cilat u mbajtën në datën 25 Prill 2021. KShH angazhoi 206 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të akredituar nga KQZ-ja. Monitorimi u shtri në 14 Bashki, respektivisht në Shkodër, Malësi e Madhe, Dibër, Kukës, Lezhë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Pogradec, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë.

Ky monitorim u bë i mundur në bazë të mbështetjes financiare të Bashkimit European dhe Republikës Federale Gjermane, prandaj është rasti që të shprehim ndaj tyre falenderimet tona të sinqerta.

KShH ndjen detyrimin, por në të njëjtën kohë edhe kënaqësinë që t'u shprehë falenderimet e përzemërta të gjithë vëzhguesve të tij që monitoruan zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Në kushtet e pandemisë ata u angazhuan vullnetarisht dhe informuan KShH-në në mënyrë të shpejtë, të saktë dhe objektive për zhvillimin e këtyre zgjedhjeve.

1. Përmbledhje Ekzekutive

Si rezultat i klimës së polarizuar politike, i krijuar kryesisht nga bojkoti parlamentar nga opozita më e madhe në vend, reforma zgjedhore u hartua në një hark relativisht të shkurtër kohor. Kjo reformë u dakordësua në qershor 2020, përmes mekanizmit të Këshillit Politik¹ dhe u votua më 23 korrik 2020, pra në më pak se një vit përpara zgjedhjeve, duke mos respektuar afatet e sugjeruara në praktikën e mira të Komisionit të Venecias². Ndryshimet e dakordësuara në Këshillin Politik, kontribuan pozitivisht në drejtim të zgjidhjes së krizës politike në vend. Nga ana tjetër, ato adresuan pjesërisht rekomandimet kyç ose prioritare të OSBE/ODIHR-t, ndërkohë që në tërësinë e saj, reforma zgjedhore nuk respektoi standartet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes, veçanërisht me organizatat e shoqërisë civile dhe grupe të tjera interesi. Kuvendi miratoi në një hark të ngushtë kohor dhe pa një studim të thelluar paraprak, ndryshimin e neneve 64 dhe 68 të Kushtetutës që sollën ndryshimin e sistemit zgjedhor.

KShH monitoroi pjesërisht veprimtarinë e organit më të lartë të administrimit zgjedhor, KQZ-së. Në këtë drejtim kishim parasysh se KQZ-ja e re dhe pa përvojën e nevojshme do të ndeshej me

¹ E cila i mundësoi opozitës jashtëparlamentare të ishte pjesë e procesit të dialogut dhe konsensusit të nevojshëm për realizimin e kësaj reforme.

² Ku thuhet se, “Elementet themelore të legjislacionit zgjedhor, në veçanti të sistemit të duhur zgjedhor, anëtarësimi në komisionet zgjedhore dhe përcaktimi të kufijve elektorale nuk duhet të jenë të hapur për ndryshime në më pak se një vit para zgjedhjeve”.

vështirësi, për shkak të volumit të ndryshimeve që pësoi Kodi Zgjedhor. Atij iu desh që brenda një kohe relativisht të shkurtër të miratonte disa vendime dhe udhëzime të ndryshme që detajonin Kodin e ri zgjedhor (të ndryshuar). Jo të gjithë anëtarët e strukturave të reja të KQZ-së kishin përvojë të mëparshme në zbatimin e legjislacionit zgjedhor dhe në disa raste, pati edhe interpretime të ndryshme. Konstatimi i KShH është se KQZ-ja edhe në këto kushte i përballoi në përgjithësi detyrat e ngarkuara. Ndasi të dukshme u vërejtën mes anëtarëve të një prej tre organeve drejtuese të KQZ-së, përkatësisht të KAS. Ky konstatim vlen për disa vendimmarrje të rëndësishme të KAS, ku subjektet zgjedhore kanë patur qëndrime të ndryshme argumentuese. Në këtë drejtim, nuk përjashtohet mundësia e influencave të natyrës politike nga forcat politike që i kanë propozuar.

Në kuadër të dekriminalizimit, sipas të dhënave të KQZ-së, ka rezultuar se në Zgjedhjet e 25 Prillit 2021, KQZ i ka dërguar Prokurorisë së Përgjithshme 30 kërkesa për verifikime të kandidatëve të propozuar nga subjektet zgjedhore, prej të cilave i janë kthyer asaj 4 raste të kandidatëve që nuk kanë patur pengesa ligjore për tu zgjedhor, referuar ligjit të dekriminalizimit. Për kërkesat e tjera vazhdon verifikimi. Verifikimi për shumicën e kandidatëve duhet bërë jashtë vendit. Përvoja e zgjedhjeve të kaluara ka vërtetuar raste kur ndonjë deputeti, kryetari, anëtari të qeverisjes vendore i është ndërprerë mandati kur ata ishin duke kryer funksionin e tyre. Koha për verifikimin midis paraqitjes së listave shumëëmërore të kandidatëve dhe përfshirja e tyre në fletën e votimit është relativisht e shkurtër. Është kjo arsyeja që KShH, në deklaratën e tij të datës 21 Janar 2021, e ka trajtuar këtë problem dhe ka sugjeruar që në të ardhmen të bëhen ndryshimet përkatëse në ligje.

Fushata zgjedhore e cila filloi përpara afatit të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor, u mbajt në një atmosferë të polarizuar politike, në cënim të masave dhe protokolleve shëndetësore për parandalimin e përhapjes së Covid-19, dhe aplikim selektiv të gjobave administrative për mosrespektimin e këtyre masave. Gjithashtu, në disa raste nuk munguan dhe elementët e gjuhës së urrejtjes, në fjalimet e liderëve partiakë.

Indicie dhe akuza për shitëblerje të votave gjatë procesit parazgjedhor u sinjalizuan në disa prej Bashkive të vendit. Ashtu si në zgjedhjet e kaluara, KShH vlerëson se hetimi i prokurorisë duhet të jetë më i shpejtë, objektiv dhe i plotë si dhe të informohet me transparencë publiku. Në faqen zyrtare të SPAK është komunikuar në dt.23 Prill³, se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vlerësuar me përparësi, në periudhën mars – prill 2021, një numër të konsiderueshëm kallëzimesh, përkatësisht 91 materiale, ku më shumë se gjysma e tyre janë nga subjektet politike dhe vetëm 4, janë depozituar nga shtetasit. Prokuroria e Posaçme referon se janë 32 procedime penale për të cilat vazhdon hetimi, janë dërguar për verifikime paraprake në Policinë e Shtetit 15 raste, janë dërguar për kompetencë prokurorive të rretheve gjyqësore 23 raste. Në vijimësi të këtij njoftimi, ende nuk ka informacion lidhur me ecurinë e hetimit të këtyre rasteve, treguesit kryesor në terma përgjithësues të hetimeve të kryera dhe vendimmarrjes së deritanishme të Prokurorisë (nëse ka patur).

Ashtu si në të kaluarën, KShH ka mendimin se shumë pak është bërë në drejtim të parandalimit dhe goditjes së krimit zgjedhor. Një nga detyrat kryesore të policisë së shtetit është parandalimi, zbulimi dhe hetimi, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, i veprave penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre (përfshi këtu veprat që çënojnë zgjedhjet e lira dhe demokratike). Për të luftuar efektivisht rastet e dyshuara të krimit zgjedhor, kërkohet që Policia e Shtetit të forcojë pavarësinë operationale, paanshmërinë politike, integritetin dhe profesionalizmin

³ <https://spak.al/2021/04/23/njoftim-23/>

si dhe transparencën, parime këto të sanksionuara në nenin 5, të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

Nisur nga një databazë me të dhëna personale dhe sensitive që qarkullonte në media dhe sinjalizohej se administrohej nga subjekti zgjedhor “PS”, në dt.14 Prill 2021, KShH reagoi me deklaratë publike duke kërkuar që subjektet zgjedhore të respektojnë të drejtën për privatësi dhe fshehtësinë e votës. Subjektet zgjedhore nuk mund të mbajnë të dhëna personale dhe sensitive të zgjedhësve, pa miratimin paraprak të tyre. KShH kërkoi nga organi i prokurorisë të informojnë me transparencë dhe paanshmëri publikun, nëse janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme për hetimin e plotë dhe të paanshëm të përgjegjësve të krijimit të saj dhe nëse janë përfshirë institucione shtetërore për kalimin e të dhënave. Edhe pse kanë kaluar gati 3 muaj, në faqen zyrtare të SPAK, me aq sa jemi njohur, nuk ka njoftim për verifikimet e kryera për këtë çështje dhe vendimmarrjen e tij.

Garantimi i të drejtës kushtetuese për të votuar i shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë territorit të vendit tonë, me keqardhje vërejmë se mbeti një zotim i parealizueshëm për shkak të mangësive në legjislacion dhe infrastrukturë. Në vlerësimin e KShH-së, KQZ-ja do të duhej që të njoftonte Kuvendin për arsyet dhe shkaqet që bënin të pamundur ushtrimin e të drejtës së votës nga emigrantët me vendbanim jashtë vendit, në referim të neneve 24, 25 dhe 46/3 të Kodit Zgjedhor.

Përgjatë periudhës 4 mujore para datës së zgjedhjeve, në disa raste nga vëzhguesit dhe koordinatorët lokalë të pozicionuar në 14 Bashkitë e vendit sinjalizuan raste për shpërdorimin e burimeve publike, për shkak të disa veprimtarive nga ana e institucioneve në nivel vendor në kundërshtim me nenin 3, pika 1, gërma a) dhe ç) të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator. Ndër sinjalizimet e referuara më së shumti nga ana e vëzhguesve konsistonte në përfshirjen e punonjësve të administratës publike në mbledhjet apo takimet e realizuara nga përfaqësues të ndryshëm të subjekteve zgjedhore. KShH vlerëson se këto sinjalizime duhet të ishin shoqëruar me një hetim pro-aktiv, më të thelluar, objektiv dhe të paanshëm nga KQZ.

Në kuadër të reformës zgjedhore është parashikuar në Kodin Zgjedhor, se çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë shkelje ligjore me natyrë administrative ose penale në fushën e zgjedhjeve ka të drejtë të infomojë drejtpërdrejtë KQZ-në. Por, meqë kjo ishte një dispozitë e re dhe koha nga miratimi i saj deri në zgjedhje ka qënë relativisht e paktë, shtetasit ose nuk janë njohur fare me të ose kanë qënë shumë pak të informuar. Sinjalizimi i shkeljeve nga publiku duhet të përbëjë një mjet efektiv që kontribuon për parandalimin dhe ndëshkimin e veprimeve të kundërligjshme, ndaj parashikimi formal nuk i shërben këtij qëllimi por duhet të shoqërohet me garancitë e nevojshme.

Siç dihet, në zgjedhjet e mëparshme është votuar për subjektin zgjedhor dhe jo edhe për kandidatin për deputet. Risi e këtyre zgjedhjeve, për shkak të ndryshimit të Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor ishte fakti që zgjedhësit ju dha mundësia të votonte paralelisht me subjektin zgjedhor, dhe kandidatin/en e tij/saj të pëlqyer të këtij subjekti. Në vijim të ankimit, Kolegji Zgjedhor duke patur parasysh vështirësitë e fletëvotimit me emra të kandidatëve (për shkak të madhësisë dhe vështirësive të printimit të fletëve të tilla) vendosi që në fletëvotimi të pasqyrohej subjekti zgjedhor dhe për kandidatët të votohej sipas kutive që në rreshtimin e tyre korrespondojnë me numrin e kandidatit, sipas listës shumëemërore të miratuar nga KQZ-ja. Me fletëvotime të tilla u votua në zgjedhjet e 25 Prillit 2021.

Në ndryshim nga klima parazgjedhore, procesi i votimit u karakterizua nga një situatë e qetë dhe pa incidente. Strukturat e policisë së shtetit, administruan me kujdesin e duhur ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike përgjatë ditës së votimit, në zbatim dhe të detyrave të ngarkuara nga Kodi Zgjedhor (neni 42 i KZ). Mgjth, votimi familjar edhe në këto zgjedhje ishte shqetësues, ndërkohë që në disa raste sporadike, vëzhguesit raportuan për fotografim ose tentativë fotografimi të fletës së votimit në dhomën e fshehtë. Kjo ndodh për shkak të tolerancës dhe papërgjegjshmërisë të disa KQV-ve. Vëzhguesit tanë gjatë monitorimit të procesit zgjedhor dhe atij të numërimit të votave kanë arritur në përfundimin se disa shkelje të ligjit dhe të udhëzimeve të KQZ-së kanë ndodhur për shkak të mostrajtit cilësor ose të pamjaftueshëm si pasojë e ngritjes me vonesë të KZAZ-ve, KQV-ve dhe grupeve të numërimit të votave ose për shkak të zëvendësimeve pas ngritjes së tyre.

Në këto zgjedhje, rezultoi që numri i pavlefshëm i votave të ishte relativisht i madh (numërimi i tyre i deklaruar: 83.000), ndërsa në zgjedhjet e mëparshme, ky numër ishte shumë më i paktë. Është e vërtetë se KQZ u angazhua që zgjedhësit të orientoreshin dhe të ndërgjegjësoreshin për mënyrën e votimit, por, koha për këtë ishte e pamjaftueshme sepse shqyrtimi dhe vendimi për përmbajtjen e fletës së votimit ishte disi i vonuar. Vështirë që në këtë fazë të jepeshin të dhëna për shkaqet e rritjes së këtij numri, sepse sipas nenit 117 pika 3 të Kodit Zgjedhor, numri i pavlefshmërisë së votave parashikohet në 10 raste. Studime më të thelluara nevojiten për të kuptuar nëse zgjedhësit nuk e kanë kuptuar si duhet sistemin e ri zgjedhor dhe fletën e votimit, duke sjellë në përqindje të caktuar pavlefshmërinë e fletës.

2. Kuadri ligjor

E shohim të nevojshme të përmendim historikun e shkurtër të periudhës 2017-2019, gjatë së cilës janë zhvilluar zgjedhjet e Kuvendit të dt. 25 qershor 2017 dhe zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të dt/ 30 qershor 2019. Këto zgjedhje janë monitoruar nga vëzhguesit e Misionit të OSBE/ODIHR, dhe pas finalizimit të raporteve të monitorimit janë shoqëruar me rekomandime ku është theksuar se duhet të rishikoheshin edhe disa rekomandime të tjera të adresuara gjatë zgjedhjeve të mëparshme që nuk ishin shqyrtuar.

Për realizimin e kësaj detyre kërkohet rishikimi i legjislacionit zgjedhor dhe rrjedhimisht mirëkuptim, fryma e dialogut dhe konsensusi i mazhorancës (PS-së) dhe opozitës (PD-së dhe LSI-së). Ishte pikërisht mungesa e tyre që u reflektua sidomos pas largimit nga kuvendi të opozitës dhe refuzimit të saj për të marrë pjesë në zgjedhjet e 30 qershorit 2019. Këto momente jo vetëm tensionuan klimën politike por e polarizuan dhe më tej atë. Kjo situatë vonoi dhe shqyrtimin e Rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it si pas zgjedhjeve të 2017 dhe atyre të 2019. Gjatë kësaj periudhe u arrit të ngrihej një Komision i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore i cili megjithëse trajtoi disa probleme, nuk funksionoi normalisht edhe për faktin sepse mungonte zëri i opozitës më të madhe jashtë parlamentare. Kjo situatë vazhdoi edhe gjatë vitit 2019, madje deri në Prill të vitit 2020. Përfaqësues të opozitës jashtëparlamentare pranuan të bashkëpunonin me mazhorancën në ndryshimet dhe shtesat që duhet t'i bëheshin Kodit Zgjedhor, pavarësisht se Kuvendi, siç përmendëm dhe më sipër, kishte ngritur një komision të veçantë për Reformën Zgjedhore.

Në dt. 5 qershor 2020 u arrit konsensusi midis përfaqësuesve të mazhorancës dhe opozitës parlamentare, si dhe përfaqësues të opozitës jashtëparlamentare për hartimin e ndryshimeve ligjore që do të adresonin rekomandimet e OSBE/ODIHR-it në fushën e zgjedhjeve.

Ky konsensus ishte i rëndësishëm, prandaj u mbështet edhe nga faktori ndërkombëtar. Më vonë, Kuvendi miratoi në një hark të ngushtë kohor dhe pa një sutdim të thelluar paraprak, ndryshimin e neneve 64 dhe 68 të Kushtetutës që sollën ndryshimin e sistemit zgjedhor dhe që bënë të nevojshëm dhe ndryshimin e disa neneve të tjera të Kodit Zgjedhor. Me këto ndryshime nuk u pajtua opozita jashtëparlamentare.

Lidhur me marrëveshjen e 5 Qershorit, që ishte një arritje e nevojshme dhe e dobishme, pavarësisht nga vërejtjet që mund të kemi për dispozita të veçanta, KShH nuk e ka quajtur të drejtë dhe as parimore përmbajtjen e pikës 10 të marrëveshjes së 5 qershor 2020, ku në pikën 10 thuhej se “projekti i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Zgjedhor nuk duhet të ndryshohej nga parlamenti”.

Sipas praktikave të mira të Komisionit të Venecias, *“Elementet themelore të legjislacionit zgjedhor, në veçanti të sistemit të duhur zgjedhor, anëtarësimit në komisionet zgjedhore dhe përcaktimit të kufijve elektorale nuk duhet të jenë të hapur për ndryshime në më pak se një vit para zgjedhjeve”*. Por praktika në Shqipëri, si rezultat i krizës dhe vonësës për konsensus politik e bëri të pamundur respektimin e këtij afati. Reforma zgjedhore u dakordësua në qershor 2020, përmes mekanizmit të Këshillit Politik dhe u votua më 23 korrik, pra në më pak se një vit përpara zgjedhjeve. Në tërësinë e saj, reforma zgjedhore u përcoll në një atmosferë të polarizuar politike, e cila cenoi standardet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes veçanërisht me organizatat e shoqërisë civile dhe grupe të tjera interesi.

Ndryshimet e dakordësuara adresuan vetëm pjesërisht rekomandimet kyç ose prioritare të OSBE/ODIHR-t, si dhe disa prej dispozitave të ndryshuara në Kodin Zgjedhor vendosën në pikëpyetje parime të rëndësishme kushtetuese, sikurse është parimi i respektimit të hierarkisë së akteve normative, parimi ndarjes dhe balancimit të pushteteve apo parimi i përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve para ligjit, etj. Rekomandimi prioritar i OSBE/ODIHR-it për depolitizimin e organeve të administrimit zgjedhor të të gjitha niveleve nuk gjeti zbatim në ndryshimet e dakordësuara për Kodin Zgjedhor.

3. Monitorimi parazgjedhor i Zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021

3.1. Ngritja dhe funksionimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Në Tetor 2020, me një procedurë të ndryshme nga zgjedhjet e mëparshme të KQZ-së u zgjodh KQZ-ja e re, pra gati 7 muaj para datës së zgjedhjeve. Ky institucion i nivelit më të lartë të administrimit zgjedhor, në kuadër të reformës zgjedhore, pësoi ndryshime si përbërje dhe strukturë, në krahasim me KQZ e mëparshme. Shqyrtimi i kandidaturave nga ana e Kuvendit, për anëtar në organet drejtuese të tij u krye në një kohë shumë të shpejtë dhe nuk garantoj një proces krejtësisht meritokratik si dhe konsultim me grupet e interesit për kandidaturat e paraqitura.

Ngritja në një periudhë relativisht të shkurtër nga data e zgjedhjeve, bëri që KQZ të punojnë në kushtet e një mbingarkese, sa i takon administrimit të procesit zgjedhor. Ky volum rritej teksa duhet të miratonte një sërë aktesh individuale apo normative, të cilat shtjellonin më tej zbatimin e Kodit Zgjedhor, i cili pësoi ndryshime të rëndësishme.

Komisioneri Shtetëror ka menaxhuar me kujdesin e nevojshëm, procesin parazgjedhor dhe atë të përshpejtimit të ritmit të numërimit të votave. Në mënyrë të veçantë, vlen të evidentohet

komunikimi i vazhdueshëm me median i Komisionerit, përgjatë gjithë procesit të menaxhimit parazgjedhor, gjatë votimit dhe numërimit në funksion të informimit të zgjedhësve. Komisioni Rregullator ka marrë vendime me unanimitet, ndërkohë që diskutimet e realizuara ndërmjet anëtarëve në mbledhjet përkatëse kanë qenë të një natyre konstruktive dhe të argumentuara.

Në ndryshim nga Komisioni Rregullator, vendimmarrje të KAS për çështje të diskutueshme nuk janë marrë me unanimitet. Në 14 vendime të KAS, konstatohet se anëtarët janë ndarë 2 me 3 ose vetëm 1 anëtar në pakicë. Duke qenë se kandidaturat për organet pjesë e KQZ janë paraqitur nëpërmjet vetë-ofrimit ose propozimit nga grupet parlamentare ose deputetët e veçantë, KShH vlerëson se në vendimmarrjet ku anëtarët e KAS janë ndarë, ekziston mundësia e influencave të natyrës politike.

Pozitiv është fakti që KQZ konsultonte në mënyrë të vazhdueshme me organizatat e shoqërisë civile, të projekt-vendimeve apo projekt-akteve të saj. Më tej, për shkak të nevojave të ngutshme të procesit, ky konsultim u realizua në një hark tepër të ngushtë kohor (mesatarisht deri në 3 ditë), çka pamundësoi dhënien e kontributeve cilësore dhe i dha nota formale procesit.

Nga monitorimet e realizuara në terren nga ekipi i vëzhguesve të KShH-së vlerësohet se zbatimi i identifikimit elektronik nëpërmjet sistemit PEI u menaxhua relativisht mirë nga KQZ, pavarësisht mungesës së efikasitetit të trajnimit të operatorëve të përfshirë në administrimin dhe monitorimin e funksionalitetit të kësaj pajisjeje.

3.2. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat e zgjedhësve

Nga monitorimi i realizuar në ambientet e zyrave të gjendjes civile dhe Njësive Administrative në 14 Bashkitë e vendit u konstatua se ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat përfundimtare të zgjedhësve respektuan parashikimet ligjore të nenit 51 pika 4 të Kodit Zgjedhor. Megjithatë u vërejt se qytetarët nuk kishin akses të plotë ndaj listave përfundimtare të zgjedhësve, për shkak të afishimit të tyre në institucione publike apo institucione arsimore, funksionale brenda orarit zyrtar.

Vendndodhjet e qendrave të votimit (QV) janë përcaktuar nëpërmjet vendimmarrjeve të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet gjatë muajve Shkurt – Mars 2021. Por në rastin e QV nr. 07091, në Njësine Administrative Shëngjin të Bashkisë Lezhë, u vërejt se ajo nuk ishte e pozicionuar pranë Shkollës, pasi kjo e fundit rezultonte e dëmtuar nga tërmeti. Mosnjohja me listat përfundimtare të zgjedhësve të kësaj QV të cilat ishin afishuar në subjektin privat “Colombo” shkaktuan konfuzion tek zgjedhësit në ditën e votimit.

3.3. Njoftimi i zgjedhësve me shkrim në banesë

Referuar detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 52 pika 1 të Kodit Zgjedhor për njoftimin me shkrim të zgjedhësve në banesa, KShH shkëmbeu disa korrespondenca zyrtare me 7 prej Njësive të Qeverisjes Vendore (Bashki)⁴. Nga të dhënat e përcjella nga këto Bashki u konstatua se procedura e njoftimit me shkrim të zgjedhësve në banesa nuk rezultonte që të ishte përfunduar, pavarësisht tejkallimit të afatit ligjor dhe shpërndarjes së fondit përkatës nga Ministria e Punëve të Brendshme.⁵

⁴ Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Elbasan, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Vlorë, Bashkia Fier, Bashkia Korçë

⁵ Neni 52, pika 5 e Kodit Zgjedhor

Duke pasur parasysh rëndësinë e njoftimit me shkrim të zgjedhësve në banesa si një element i rëndësishëm i garantimit të pjesëmarrjes së tyre në ditën e votimit, vlerësojmë se masa paraprahe monitoruese dhe periodike duhet të ishin marrë nga institucioni administrues i procesit zgjedhor KQZ.

3.4. Votimi i shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit

Për herën e parë, ligjbërësi në Kodin Zgjedhor ka miratuar 3 dispozita ligjore (nenet 24, 25 dhe 46 pika 3), që i garantonin disasporës shqiptare të drejtën për të votuar nga shtetet e huaja ku kanë vendbanimin e përhershëm. Kjo e drejtë duhet të realizohej duke filluar nga Zgjedhjet Parlamentare të dt.25 Prillit 2021. Në fakt kjo e drejtë nuk u respektua. KShH në muajin Tetor 2020 në një vezhim të kryer në 11 njësitë e qeverisjes vendore, veç të tjerave, u informua se në Regjistrat e Gjendjes Civile nuk ekzistonin adresat e banimit të përhershëm të shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit, gjë që e kërkonin dispozitat e mësipërme. Për këtë KShH vuri në dijeni KQZ-në. Kjo ishte e dhëna e parë.

Veç kësaj në ligjin e vitit 2016 për disa të drejta që u garantoheshin shtetasve shqiptarë jashtë vendit nuk bëhet fjalë për adresat e përhershme të banimit të tyre për efekt të zgjedhjeve. Vendimi i Këshillit të Ministrave që i referohet dispozitave të këtij ligji (i miratuar në dhjetor të vitit 2020) megjithëse përmend të drejtën e zgjedhjes së shtetasve shqiptarë jashtë vendit, nuk bën fjalë për adresat e banimit të përhershme të tyre dhe as për procedurën që duhej ndjekur. Kjo edhe për faktin se Vendimi i Këshillit të Ministrave mbështetej në një ligj që ishte miratuar para 4 viteve dhe dispozitat përkatëse të tij si objekt nuk kishin garantimin e së drejtës së tyre në zgjedhje.

KShH, qysh kur u miratuan dispozitat e përmendura më lart, parashtroi opinionin se ligjvënësi duhet që për disa çështje të mos ngarkonte KQZ-në për t'i zgjidhur me akte nënligjore sepse kishte nga ato që ishin atribut i legjislativit. Para kësaj situate, KQZ-ja u mjaftua me një njoftim se për Zgjedhjet e 25 Prillit 2021, kjo detyrë nuk mund të realizohej. Nga ana e KQZ-së, përveç disa daljeve publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk pati një vendimarrje të arsyetuar mbi sfidat dhe vështirësitë me të cilat u përball administrata zgjedhore në nivel qendror, të cilat e penguan që të vinin në funksion këtë sistem. Tërheq vëmendjen fakti se dy partitë më të mëdha të pozitës dhe opozitës parlamentare dhe jashtë parlamentare nuk bënë deklaratat apo ankesa për këtë qëndrim të KQZ-së.

3.5. Shpërdorimi i burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve

Më datë 24.12.2020, KQZ komunikoi rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve. Kjo vendimarrje e KQZ-së u shoqërua me një sërë diskutimesh dhe qëndrime të ndryshme ndërmjet anëtarëve të KAS, si një organ ankimor, çka reflektoi ndasi ndërmjet anëtarëve të propozuar nga përfaqësues të forcave të ndryshme politike.

KQZ garantoj akses për publikun e gjerë për përcjelljen e denoncimeve nëpërmjet seksionit “Aktivitete të ndaluara” në faqen e tij zyrtare në internet.⁶

Përgjatë periudhës 4 mujore para datës së zgjedhjeve, në disa raste nga vëzhguesit dhe koordinatorët lokalë të pozicionuar në 14 Bashkitë e vendit pati sinjalizime për shpërdorimin e burimeve publike, për shkak të disa veprimtarive nga ana e institucioneve në nivel vendor në kundërshtim me nenin 3, pika 1, gërma a) dhe ç) të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator. Pas njohjes me vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës për përjashtimin e bizneseve nga detyrimi për pagesën e tarifës së zënies së hapësirës publike dhe shtyrjen e pagesës së taksave dhe tarifave vendore, të publikuar në median elektronike, KShH reagoi publikisht⁷ duke vlerësuar se ky vendim krijonte premisa për keqpërdorim të burimeve shtetërore dhe pabarazi në garën elektorale. Gjithashtu, Bashkia Pogradec lëshoi lejen infrastrukturore nr. 3893 prot., dt. 16.08.2020 për punime në objektin “Rehabilitimi i rrugëve, shesheve e fasadave, blloku tek lagjia nr. 2”. Referuar përmbajtjes së kësaj lejeje afati për përmbylljen e punimeve shënonte 16 muaj nga dita e fillimit të tyre, ndërkohë që nga nga të dhënat e grumbulluara në terren, si dhe postimeve në faqen Facebook të Bashkisë Pogradec dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, punimet efektivisht kanë filluar në fillim të muajit Mars 2021, pra rreth 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve.

Gjatë fushatës zgjedhore, ndër denoncimet e referuara më së shumti nga ana e vëzhguesve konsistonte në përfshirjen e punonjësve të administratës publike në mbledhjet apo takimet e realizuara nga përfaqësues të ndryshëm të subjekteve zgjedhore, gjatë orarit zyrtar të punës. P.sh: Drejtuesit e Njesisë Administrative, Rajoni 4 në Durrës u përfshinë në veprimtari zgjedhore brenda orarit zyrtar të punës.⁸ Ndërkohë kandidati i një subjekti politik në Bashkinë Dibër i shoqëruar me përfaqësues të autoriteteve publike në nivel drejtues dhe specialist realizoi një takim elektorale në fshatin Pilafë të Njesisë Administrative Tomin në orën 12:00 të datës 13 Prill 2021. Takim elektorale me pjesëmarrje të nivelit të lartë drejtues u denoncuan dhe në Njesisë Administrative Sllovë, të Bashkisë Dibër.

Kryetari i Bashkisë Dibër, njëkohësisht kandidat për deputet në Zgjedhjet Parlamentare 2021, publikoi në rrjetin e tij social Facebook kopjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për rikonstrukcionin e segmentit rrugor Perlat-Kurbnesh-Krej Lurë-Fushë Lurë. Ndërsa furnizimi për herë të parë me ujë i fshatit Boriç i Vogël në Bashkinë Malësi e Madhe, rreth 9 ditë para zgjedhjeve u promovua në faqen e Facebook të kandidatit për deputet për Qarkun Shkodër si një angazhim primar i qeverisë shqiptare.

Këto denoncime të përcjella nga ana e koordinatorëve lokalë iu përcollën nëpërmjet korrespondencës zyrtare KQZ-së, ndërkohë që pas shqyrtimit të 2 prej këtyre denoncimeve⁹, KQZ vendosi përfundimin e shqyrtimit administrativ duke mos konsideruar veprimtaritë e denoncuar në cënim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. KShH

⁶ <https://aktivitete.kqz.gov.al>

⁷ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/04/20210407164839700.pdf?fbclid=IwAR1lDD0e15_2_8vBUlBIG6OIO3KcXilsgCt28reY8aerwrfT9WtqDLgKCYk

⁸ <https://www.facebook.com/104485125050487/posts/118996800265986/?sfnsn=mo> Perfshirja e Kryetares së Njesisë Administrative, Rajoni 4 Durrës

⁹ http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/210414_Vendim-233-Per-shqyrtimin-e-denoncimit-ndaj-Donika-Hysenaj-1.pdf
<http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/Vendim-nr.385-dt.8.6.2021-Per-shqyrtimin-administrativ-te-denoncimit-ndaj-Dionis-Imeraj.pdf>

vlerëson se këto sinjalizime duhet të shoqëroheshin me një hetim pro-aktiv, më të thelluar, objektiv dhe të paanshëm nga KQZ.

3.6. Regjistrimi i partive dhe i koalicioneve

Datat 15 dhe 25 Shkurt 2021 përkonin me afatin final brenda të cilit duhet të përfundonte procesi i regjistrimit të partive politike dhe koalicioneve zgjedhore. Fillimisht 46 parti politike u regjistruan për të garuar për Zgjedhjet Parlamentare Prill 2021, si dhe 3 koalicione. Duke qenë se jo të gjitha partitë politike respektuan kriteret për depozitimin e dokumentave mbështetës për kandidatët pjesë e listave shumë-emërore por edhe afatet për plotësimin e të metave, si rrjedhojë në garë u përfshinë 17 subjekte zgjedhore, nga të cilat 3 koalicione dhe 5 kandidatë të pavarur.

3.6.1. Paraqitja e listave shumë-emërore të kandidatëve

Data 8 Mars 2021 shënonte afatin ligjor, brenda të cilit partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore ose koalicionet zgjedhore duhet të depozitonin pranë KQZ-së listën shumëemërore të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore.¹⁰ Ndër aktet e kërkuara ishin dhe formularët e vetë-deklarimit, si një element i rëndësishëm i procesit të zbatimit të legjislacionit për dekriminalizimin. KQZ njoftoi se 9 parti politike dhe 3 koalicione zgjedhore dorëzuan listat shumëemërore të kandidatëve për deputet në përputhje me afatin ligjor. Në vendimin nr. 156 të datës 17/03/2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi kërkesën e koalicionit PD-AN, përkundrejt kushteve të përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor. Në interpretimin e Komisionerit, paragrafi 4 i nenit 67 të Kodit Zgjedhor përcakton numrin e saktë të kandidatëve që duhet të përmbajnë listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore. Por i njëjti argumentim nuk u mbështet nga ana e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), i cili rrëzoi vendimin e Komisionerit me vendimmarrje të ndarë në 3 vota pro dhe 2 kundër. Në interpretimin e KAS, dispozita e sipërcituar përcakton kufirin minimal të numrit të kandidatëve. Por edhe ky vendim i KAS dhe rrjedhimisht interpretimi i bërë prej tij nuk ishte përfundimtar, pasi Kolegji Zgjedhor, në vendimin nr. 3, datë 29/03/2021, rrëzoi vendimin e KAS duke risjellë interpretimin fillestar të dispozitës.

Në kuadër të reformës zgjedhore, ndryshimi që ju bë nenit 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor, konsistonte në dhënien e të drejtës për kryetarët e partive (subjekteve zgjedhore) apo të partive udhëheqëse të koalicionit që të konkurrojnë si kandidatë për deputetë deri në 4 zona zgjedhore. KShH reagoi publikisht kundër këtij ndryshimi (përrjashtimi) që binte ndesh me parimin e barazisë dhe që ishte diskriminues. Cënimin e këtyre parimeve e evidentoi dhe Komisioni i Venecias në opinionin e muajit Dhjetor 2020, madje rekomandoi që kjo dispozitë pas Zgjedhjeve të Kuvendit të rishqyrtohej. Pas këtij opinionin, KShH reagoi përsëri dhe sugjeroi që kryetarët e partive edhe në zgjedhjet e 25 Prillit 2021 ta vinin kandidaturën vetëm në një zonë. Në fakt, në listat shumëemërore që ju paraqitën KQZ-së rezultoi se Kryetari i PS-së kishte vënë kandidaturën në 2 zona (Durrës dhe Vlorë), Kryetari i Partisë Balli Kombëtar në 4 zona (Berat, Fier, Korçë dhe Tiranë), Kryetari i Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare në 4 zona (Elbasan, Fier, Korçë dhe Tiranë), Kryetari i Partisë Thurja në 4 zona (Durrës, Korçë, Shkodër dhe Tiranë), Kryetarja e Partisë “Lëvizja për Ndryshim” në 4 zona (Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër), Kryetarja e LSI-së në 3 zona (Elbasan, Fier dhe Tiranë) dhe Kryetari i PSD-së në 2 zona (Shkodër dhe Tiranë).

¹⁰ Neni 67 pika 1 tw Kodit Zgjedhor

3.7. Përmbajtja e fletës së votimit

Me datë 1 prill 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi Vendimin nr. 198 “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”, pasi Komisioni Rregullator shpalli moskompetencën për vendimmarrjen lidhur me fletën e votimit. Konflikti i krijuar për kompetencën midis Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit Rregullator në këndvështrimin tonë është një çështje e interpretueshme. Megjithatë, pavarësisht se neni 20 i Kodit Zgjedhor nuk parashikon shprehimisht si kompetencë të Rregullatorit miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit, nga ana tjetër kjo vendimmarrje ka karakter normativ pasi shtrihet në të gjithë territorin e vendit dhe neni 20, në pjesën hyrëse të tij ia ngarkon Rregullatorit shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ.

Vendimmarrja e Komisionerit u ankimua nga ana e 3 subjekteve zgjedhore, duke mbështetur pretendimet e tyre në numrin e lartë të emrave të kandidatëve, për pasqyrimin me emra të kandidatëve dhe jo me numra në fletën e votimit, lidhur me siglën e partisë Bindja Demokratike, etj.

Nëpërmjet vendimit nr. 19, datë 03.04.2021, KAS vendosi ndryshimin e vendimmarrjes së Komisionerit duke pranuar pjesërisht kërkesat ankimore të depozituara. Ndaj vendimmarrjes së KAS, Koalicioni PD-AN depozitoi ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, ndërkohë subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integritet iu bashkua ndërgjyqësisë në cilësinë e ndërhyrësit dytësor. Duke qenë se brenda këtij shqyrtimi gjyqësor u ngritën dy mosmarrëveshje, konkretisht pasqyrimi me emra apo me numra të listës shumëmemërore të kandidatëve të subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, si dhe mosmarrëveshja në lidhje me logon e subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike, e pasqyruar në fletën e votimit, Kolegji disponoi në vendimmarrjen e tij argumentimet respektive.

- Fleta e votimit e miratuar nga KAS, sa i përket parametrave teknikë rezulton se ka respektuar përmasat fikse sipas vendimit nr.6, datë 26.02.2021 të Komisionit Rregullator;
- Duke qenë se koalicioni PD-AN dhe Partia Bindja Demokratike nuk mund të garojnë me logo të ngjashme, u vendos lënia në fuqi e vendimmarrjes së Komisionerit pasi logo e ristilizuar e kësaj partisë BD e cila u pranua nga ana e KAS krijonte konfuzion tek zgjedhësit.

Duke qenë se kjo vendimmarrje ishte e kushtëzuar edhe nga komunikimi i kompanisë së kontraktuar për prodhimin e fletëve të votimit, me qëllim respektimin e datës 25 Prill 2021, Kolegji Zgjedhor nuk e thelloi hetimin e tij gjyqësor në përmbajtjen e fletëve të votimit.

Nga të dhënat e përcjella nga vëzhguesit e KShH-së, të cilët kanë monitoruar procesin e votimit dhe janë ndeshur me pakënaqësi të qytetarëve, konstatohet se fleta e votimit në këndvështrimin e qytetarëve nuk ka përmbushur plotësisht kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 98 KZ, në pikëpamjen e qartësisë, kuptueshmërisë dhe orientimit të duhur të zgjedhësit. Ndërkohë që zgjedhësve iu është dashur shumë kohë për t’u njohur me emrat dhe numrat e renditjes së kandidatëve, të afishuara në një listë në formë poster. Sa i përket afishimit të kësaj liste poster në QV objekt monitorimi është konstatuar se nuk ka qenë e unifikuar kjo praktikë. Disa kanë zgjedhur t’i vendosin këto lista në ambientet e brendshme të QV, ndërsa disa të tjerë kanë zgjedhur që 1 listë ta vendosin në ambientet e jashtme të QV, pranë derës së hyrjes. Për këtë mënyrë afishimi, nuk konstatohet që KQZ të ketë publikuar ndonjë udhëzim apo manual konkret.

4. Ngritja e infrastrukturës së administratës zgjedhore në nivel vendor: KZAZ, KQV dhe GNV

4.1. Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve

Në vijim të vendimmarrjes së organeve të KQZ-së, specifikisht Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve¹¹ dhe Komisionit Rregullator¹², lidhur me ngritjen dhe përcaktimin e organizimit të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), KShH monitoroi në mënyrë proaktive ngritjen dhe funksionimin e 31 KZAZ-ve ose rreth 34% të numrit total të KZAZ-ve në rang vendi.¹³ Referuar vendimit nr. 15/2021 të Komisionerit, datat 28-29 Janar u përcaktuan si data për ngritjen e KZAZ-ve dhe thirrjen e mbledhjes së parë. Përgjithësisht administrata zgjedhore në nivel vendor respektoi afatin 90 ditor të parashikuar në nenin 28 të Kodit Zgjedhor, me përjashtim të disa prej KZAZ-ve në Bashkinë Elbasan dhe KZAZ nr. 69 pranë Bashkisë Pogradec, të cilat realizuan mbledhjen e parë gjatë muajit Shkurt 2021. Ndërkohë nga verifikimi i librit të protokollit pranë KZAZ nr. 13 Bashkia Lezhë, u konstatua se asnjë mbledhje e saj nuk është dokumentuar.

Në përgjithësi selitë e KZAZ-ve të monitoruara ishin vendosur në ambiente publike, me përjashtim të KZAZ nr. 84 pranë Bashkisë Vlorë e cila deri më dt. 05/03/2021 ushtroi veprimtarinë e saj në mjediset e zyrës së nën/kryetarit të Bashkisë Vlorë. Edhe pse misionet monitoruese të ndërmarra nga vëzhguesit e KShH-së janë realizuar pas kontaktit paraprak telefonik, janë vënë re mungesa të pranisë së anëtarëve të disa KZAZ-ve, pavarësisht caktimit të orarit zyrtar për funksionimin e KZAZ-ve¹⁴. Duke qenë se disa prej anëtarëve të KZAZ-ve ishin funksionarë publikë dhe ishin autorizuar për t'u angazhuar në KZAZ, mosprania e anëtarëve ngre dyshim për shpërdorim të burimeve njerëzore gjatë procesit zgjedhor.

Anëtarët e KZAZ-ve u trajnuan përafërsisht 2 muaj me vonesë nga data kur duhej të ishin ngritur dhe mbledhur, element i cili ndikoi në efikasitetin e zbatimit të detyrave të tyre.

4.2. Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve

Nga monitorimet e realizuara në muajin Prill 2021, u vërejt se procesi i ngritjes së Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) u shoqërua me vonesa për shkak të dorëzimit jasshtë afatit në KZAZ të propozimeve për anëtarë/sekretarë (jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve), dhe vonesave të KZAZ-ve për të marrë vendim përfundimtar (jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve). Për shkak të përfshirjes së platformës online të raportimit nga ana e anëtarëve të KQV-ve dhe përdorimit të teknologjisë që mundësonte identifikimin biometrik të zgjedhësit, KShH vlerëson se trajnimet e anëtarëve të KQV, të zhvilluara në datat 18-23 prill ishin të vonuara. Pjesëmarrja në këto trajnime ishte e ulët në disa prej Bashkive të monitoruara.

¹¹ Vendim nr. 15, datë 25.01.2021 “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”; Vendim nr. 14, datë 25.01.2021 “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”; Vendim nr. 22, datë 02.02.2021 “Për emërimin e kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”

¹² Vendim nr. 05, datë 20.11.2020, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”

¹³ Nw rang vendi nw Zgjedhjet Parlamentare Prill 2021 janw ngritur 92 KZAZ

¹⁴ Orari i KZAZ-ve 09.00 - 13.00 dhe 16.00 - 20.00.

4.3. Ngritja e GNV-ve

Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) në disa raste u shoqërua me problematika dhe vonesa, duke mos respektuar kërkesat e nenit 95 të Kodit Zgjedhor. Nga KZAZ-të e monitoruara rezultoi se në KZAZ nr. 35, Bashkia Tiranë, KZAZ nr. 83 në Vlorë, KZAZ nr. 81 në Gjirokastrë dhe KZAZ nr. 84 dhe nr. 86 pranë Bashkisë Vlorë, GNV-të nuk ishin ngritur me një diferencë 5 ditë, në tejkalim të afatit ligjor. Në këto 2 të fundit, shkak ishte bërë konflikti politik mes subjekteve LSI dhe PDIU, sa i takon emërimin të numëruesit të katërt, sipas nenit 96 të Kodit Zgjedhor.

Me përjashtim të KZAZ nr. 1 në Bashkinë Malësi e Madhe, e cila e ka realizuar trajnimin e anëtarëve të GNV-ve rreth 3 ditë përpara zgjedhjeve, KSHH ka konstatuar se trajnimi i anëtarëve të GNV-ve është realizuar rreth 1 orë më përpara vendimmarrjes së hapjes së procesit të numërimit të votave nga KZAZ-të. Ky hark kohor i shndërruar në praktikë jo pozitive gjatë proceseve zgjedhore në vendin tonë, vlerësojmë se nuk i shërben eficiencës së trajnimeve dhe realizimit të një procesi numërimi konformë parashikimeve ligjore në fuqi.

5. Fushata zgjedhore dhe incidentet

Fushata zgjedhore e cila filloi përpara afatit të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor, u mbajt në një atmosferë të polarizuar politike, të shoqëruar me akuza reciproke midis përfaqësuesve të forcave politike kryesore si dhe në cënim të masave dhe protokolleve shëndetësore për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Gjithashtu, në disa raste nuk munguan dhe elementët e gjuhës së urrejtjes, në fjalimet e liderve partiakë. Situata e pandemisë, por edhe mënyra se si subjektet realizuan fushatën zgjedhore, kufizuan deri në një farë mase, njohjen e zgjedhësve me platformat elektorale dhe profilet e kandidatëve.

Masa administrative me gjobë u vendosën ndaj 2 kandidatëve të pavarur në Qarkun Lezhë dhe Dibër, të cilët u referuan se kanë cënuar masat dhe protokollet anti-Covid 19, përbën në vlerësimin tonë, një ndëshkim jo proporcional dhe i vendosi subjektet garuese në pozita diskriminuese, në raport me tolerancën e treguar ndaj fushatës së forcave kryesore politike (të cilat në disa raste nuk i respektuan këto masa).

Nga monitorimi i vendimmarrjeve të kryetarëve të Bashkive për afishimin e materialeve propagandistike u konstatua se Bashkitë Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës dhe Dibër nuk respektuan detyrimin ligjor për publikimin e këtyre vendimeve në faqet e tyre zyrtare.

Në Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Gjirokastrë u konstatua cënim i vendimit nr. 6, datë 23/03/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pasi në fasadat e Universitetit Politeknik ose Pallatit të Sportit u afishuan materiale propagandistike të subjekteve zgjedhore.

Zyrat zgjedhore në Bashkitë Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Elbasan u ngritën para afatit ligjor të fushatës zgjedhore dhe përmbanin elementë të fushatës si logot, posterat dhe motot e subjekteve zgjedhore, në kundërshtim me nenin 79 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet afishimi i materialeve propagandistike pranë zyrave zgjedhore vetëm përgjatë fushatës zgjedhore (duke filluar nga data 26 mars). Ndërkohë në bulevardin Republika të Bashkisë Berat, një zyrë zgjedhore u ngrit dhe ushtroi funksionin e saj rreth 150 m pranë KZAZ nr. 65.

Indicie dhe akuza për shitëblerje të votave gjatë procesit parazgjedhor u sinjalizuan në disa prej Bashkive të Vendit. Në rastin e incidentit të regjistruar në Bashkinë Berat, Prokuroria përcolli pranë SPAK kallëzimin e depozituar nga subjekti zgjedhor PD ndaj zyrtarëve lokalë nën akuzën e

“Korrupsionit pasiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 K.Penal. Arrestimi në flagranci i 2 shtetasve për veprat penale ‘Korrupsioni aktiv në zgjedhje’ kryer në bashkëpunim dhe ‘Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore’ u shënua në Bashkinë Dibër, ndërkohë që çështja u referua pranë organeve proceduese. KShH vlerëson se hetimi i prokurorisë duhet të jetë pro-aktiv, i gjithëanshëm, i shpejtë, objektiv si dhe të informohet me transparencë publiku, nëse mbarëvajtja e këtyre hetimeve nuk cenohet apo pengohet. Gjithashtu, kemi mendimin se duhet të forcohet puna e organeve ligjzbatuese për parandalimin dhe goditjen e veprimeve të dyshuara që dënohen penalisht dhe që cenojnë zgjedhjet e lira dhe demokratike, veçanërisht e Policisë së Shtetit, e cila duhet të udhëhiqet nga parimi i paanshmërisë dhe profesionalizmit, në përmbushjen e misionit të saj.

Në faqen zyrtare të SPAK rezulton i publikuar njoftimi i dt.23 Prill¹⁵, se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vlerësuar me përparësi të gjitha rastet e paraqitura nga subjekte të ndryshëm, që lidhen me veprat penale në fushën e zgjedhjeve, “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe “Korrupsioni pasiv në zgjedhje”, apo ndaj subjekteve të ndryshëm, që janë kompetencë hetimi të kësaj prokurorie. Në periudhën mars – prill 2021 janë paraqitur një numër i konsiderueshëm kallëzimesh, përkatësisht 91 materiale, të specifikuara si vijon, 55 raste nga subjektet politike, 10 raste, referim nga policia gjyqësore, 4 raste procedime penale të referuara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, 4 raste nga shtetas dhe 18 raste nga Institucioni i Presidentit. Bazuar në këto materiale, janë regjistruar 32 procedime penale për të cilat vazhdon hetimi, është vendosur në 7 raste mosfillimi i procedimit penal, janë dërguar për verifikime paraprake në Policinë e Shtetit 15 raste, janë dërguar për kompetencë prokurorive të rretheve gjyqësore 23 raste si dhe janë në proces verifikimi nga prokurorët e posaçëm 14 raste.

6. Monitorimi i procesit të votimit

Procesi i votimit, i cili u realizua në dt.25 Prill, u monitorua nga 195 vëzhguesit e KShH-së, në 424 qendra të votimit (QV), të ngritura në 14 Bashkitë e vendit. Përgjithësisht vëzhguesit e KShH-së nuk janë përballur me raste të kufizimit të aksesit nga ana e administratës zgjedhore në nivel lokal, por u regjistruan raste të intimidimit, kërcënimit apo pengimit të ushtrimit të funksionit të vëzhguesve nga persona të paautorizuar, të pranishëm brenda ose afër ambienteve të jashtme të QV-ve.

Gjatë procesit të votimit, situata raportohet të ketë qenë e qetë dhe pa incidente. QV-të e monitoruara në 14 Bashkitë e vendit në përgjithësi u hapën brenda orarit 7.00 të parashikuar në nenin 11 të Kodit Zgjedhor, por në disa prej tyre u konstatuan vonesa përafërsisht 30-40 min. Vonesa u shkaktua për shkak të mosprezencës së operatorëve për vënien në funksion të sistemit PEI, mosfunksionimit të pajisjes së identifikimit elektronik (PEI)¹⁶, vonesa në paraqitjen e anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit apo vonesë në përgatitjen e sallës së votimit¹⁷, mungesë e procesverbalit të hapjes së procesit të votimit, ndërprerjes së energjisë elektrike¹⁸ etj.

Gjatë ditës së votimit, u evidentuan raste të shumta të pezullimit të procesit të votimit për shkak të problemeve me funksionimin e pajisjes PEI. Për rrjedhojë, në disa prej QV-ve të monitoruara,

¹⁵ <https://spak.al/2021/04/23/njoftim-23/>

¹⁶ QV 2374 Bashkia Elbasan, QV 4242/1 Bashkia Gjirokastrë, QV 2998 Bashkia Fier.

¹⁷ QV 637/1 Bashkia Kukës; QV 3908 Bashkia Pogradec, QV 3907 Bashkia Pogradec.

¹⁸ QV 3269 të Bashkisë Berat votimi ka filluar rreth gjysëm ore me vonesë për shkak të mungesës së energjisë elektrike

procesi i identifikimit të zgjedhësve u krye në mënyrë manuale, duke verifikuar letërnjoftimin biometrik të paraqitur me anë të listave të zgjedhësve. Kjo solli mungesë të unifikimit të praktikës nga KQV-të, të cilat përdorën vetëm praktikën e heqjes së vizës në listën e zgjedhësve sipas nenit 105, gërma c) të Kodit Zgjedhor, dhe disa prej QV të tjera në të cilat u përdor vetëm sistemi i regjistrimit të zgjedhësve nëpërmjet pajisjes PEI, por nuk u zbatua paralelisht dhe praktika e parë.

Në rastet ku verifikimi i identitetit të zgjedhësve u bë nëpërmjet pajisjes PEI, KQV nuk udhëzoi zgjedhësit të nënshkruanin përbri emrit të tyre në listën e zgjedhësve¹⁹, apo t'i hiqej vizë emrit të tyre²⁰. Gjithashtu, u raportuan raste kryesisht të zgjedhësve të moshuar ku shenjat e gishtërinjve të zgjedhësve nuk janë identifikuar nga pajisja PEI²¹. Vëzhguesit e KShH-së evidentuan raste të mosfunksionimit të kamerës së vëzhgimit në QV²², ndërkohë që disa zgjedhës që u paraqitën për të votuar në disa QV, nuk u timbrosën nga ana e anëtarëve të KQV-së²³, apo nuk u kontrolluan paraprakisht nëse ishin timbrosur, përpara se t'i jepej fleta e votimit²⁴.

Përgjatë procesit të votimit, KShH u sinjalizua lidhur me praninë e personave të paautorizuar, brenda ose në ambientet e jashtme hyrëse të QV-së, të cilët orientonin apo shoqëronin zgjedhësit për në qendrat e votimit²⁵. Përdorimi i bexhave në format të fotokopjuar dhe jo sipas modelit të miratuar nga ana e KQZ-së është vërejtur në rastin e vëzhguesve të subjekteve politike, bexhat e të cilëve janë nënshkruar nga kryetari i KZAZ. Anëtarët e KQV-ve rrallë herë morën masa për largimin e personave të paautorizuar nga ambientet e QV-së, nëpërmjet njoftimit të oficerëve të policisë.

Në cënim të parimit të fshehtësisë së votës, nga vëzhguesit e KShH-së u raportuan raste të votuesve të cilët u shoqëruan dhe u asistuan në dhomën e fshehtësisë nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore apo anëtarët e KQZ-së. Gjithashtu, në ambientet e disa prej KQV-ve u vërejtën vëzhgues të subjekteve zgjedhore të cilët mbanin shënim emrat e zgjedhësve, në momentin e referimit me zë, nga anëtarët e KQV-së.

Votimi familjar është lejuar nga disa anëtarë të QV-së, të cilët e ngatërronin duke e konsideruar si ndihmë ndaj zgjedhësve të cilët nuk votojnë vetë, sipas nenit 108 të Kodit Zgjedhor. Vëzhguesit e KShH-së raportuan raste të votimit familjar në disa Bashki të vendit, ndërkohë që vërejtjet me shkrim të vëzhguesve, në rast se do të ishin pranuar nga ana e anëtarëve të KQV-së do të passillnin parandalimin e këtij fenomeni²⁶.

Administrata zgjedhore i kushtoi vëmendje deri në një farë mase ndalimit të fotografimit të votës dhe përdorimit të telefonit gjatë procesit të votimit, një veprim tashmë i parashikuar si vepër penale

¹⁹ QV 1498, 1460 Bashkia Durrës, QV 0274, 0260 Bashkia Shkodër, QV 1767, 2002 Bashkia Tiranë, QV 39201, QV 3291, QV 3292, QV 3279, QV 3280 dhe QV 3281/1 në Bashkinë Berat

²⁰ QV 1767, 1804 Bashkia Tiranë, QV 4507/1 Bashkia Vlorë, QV 0260 Bashkia Shkodër, QV 3291 dhe QV 3290/1 Bashkia Berat.

²¹ QV 1460, Bashkia Durrës

²² QV 1429/2, Bashkia Durrës

²³ QV 2390, Bashkia Elbasan, QV 4440, Bashkia Vlorë

²⁴ QV 3641/1, Bashkia Korçë

²⁵ QV 255/1, 259 Bashkia Shkodër, QV 1844 Bashkia Tiranë, QV 3026/1 Bashkia Fier, QV 43131 Bashkia Gjirokastrë, QV 3294 Bashkia Berat

²⁶ QV 1411/2, 1489/1, 1449/2, Bashkia Durrës, QV 4235 Bashkia Gjirokastrë, QV 1724 Bashkia Tiranë, QV 364/1 Bashkia Korçë, QV 0255/1, 260 Bashkia Shkodër, QV 1143, 1149, 1144, 1157 Bashkia Dibër, QV 3889 dhe 3908 Bashkia Pogradec

në nenin 327 të Kodit Penal. Pavarësisht thirrjeve të vazhdueshme nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, KShH u sinjalizua për tentativa të fotografimit të votës²⁷ apo përdorimit të telefonit²⁸ në disa prej QV-ve, në 14 Bashkitë objekt monitorimi.

Rreth 12 ditë përpara datës së zgjedhjeve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe KQZ publikuan protokollin për parandalimin e përhapjes së Covid-19 gjatë procesit të votimit. Ky protokoll u shndërrua në një dokument formal dhe i pamundur që të respektohet në të gjitha QV të monitoruara. Për shkak të kushteve logjistike të ambienteve në të cilat ishin parashikuar të ngrihen QV, vëzhguesit e KShH-së raportuan raste të disa prej QV të vendosura në kate të II-ta të godinave dhe jo të pajisura me dy dyer për të mundësuar ajrosjen e plotë të ambientit²⁹. Në përgjithësi u konstatua se masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19 (si mbajtja e maskës, distancimi fizik dhe higjienizimi i duarve) nuk u zbatuan nga ana e zgjedhësve dhe anëtarëve të KQV-ve.

Vëzhguesit e KShH-së u angazhuan në monitorimin e 4 qendrave të posaçme të votimit të ngritura në 4 burgje të vendit, si IEVP Drenovë (QV 3707/1), IEVP Durrës (QV 14222), IEVP Shënkoll (QV 07481) dhe IEVP Rec (QV 00641). Pjesëmarrja e zgjedhësve në këto QV ka rezultuar e ulët, ndërkohë që është vërejtur mungesë e sensibilizimit të tyre mbi procedurën e të votuarit dhe risinë e sistemit të ri zgjedhor që mundësonte zgjedhjen e kandidatit të parapëlqyer të subjektit zgjedhor. Vëzhguesit e KShH-së në këto QV nuk kanë raportuar raste të dukshme apo të konstatueshme përgjatë procesit, të intimidimit apo ushtrimit të presionit nga ana e punonjësve të Policisë së Burgjeve apo përfaqësuesve të administratës së institucionit, me qëllim ndikimin mbi vullnetin e shtetasve të privuar nga liria.

Në shumicën e QV-ve të monitoruara, procedura e mbylljes së procesit të votimit u zhvillua normalisht, në përputhje me parashikimet ligjore të mbylljes së QV-së në orën 19.00. Në disa prej QV-ve u raportuan vonesa deri në 1 orë, për shkak të prezencës së zgjedhësve që prisnin në radhë për të votuar dhe vonesave në hartimin e procesverbaleve të mbylljes së votimit³⁰. Në përgjithësi, materialet zgjedhore u transportuan drejt VNV-ve në përputhje me nenin 114 të Kodit Zgjedhor, me përjashtim të QV nr. nr. 0740, kutia e materialeve dhe e votimit të së cilës nuk u shoqërua me prezencën e punonjësit të Policisë së Shtetit.

7. Monitorimi i procesit të numërimit të votave

Në vijim të mbylljes së procesit të votimit për Zgjedhjet për Kuvend, të dt. 25 prill 2021, KShH u angazhua në monitorimin e 21 Vendeve të Numërimit të Votave (VNV) në 14 Bashki. Parashikimi ligjor për mbërritjen në VNV-ve të kutive të votimit të të gjitha QV-ve në juridiksionin e KZAZ-së, brenda 3 orësh prej mbylljes së votimit, përgjithësisht, nuk u respektua³¹. Në vijim të dorëzimit të kutive të votimit, u raportua se KZAZ-të zhvilluan trajnimet e anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave (GNV), trajnime të cilat nuk u lejuan të monitoroheshin nga vëzhguesit e akredituar të KShH-së. Flagrant u konstatua rasti i raportuar nga KZAZ nr. 48 në Bashkinë

²⁷ QV 3026, Bashkia Fier, QV 3889 dhe 3891/2 Bashkia Pogradec.

²⁸ QV 1468/1, 1470/1, 1429 Bashkia Durrës, QV 3696/1, 3664/1 Bashkia Korçë, QV 1887/1 Bashkia Tiranë

²⁹ QV 0648, Bashkia Kukës

³⁰ QV 3016 Bashkia Fier (19.50); QV 260 (20.03), QV 259/1 (19.40), QV 259 (19.36) Bashkia Shkodër, QV 4440 Bashkia Vlorë (19.35), QV 0633 (20.01), QV 0648, QV 0649 (19.47) Bashkia Kukës

³¹ KZAZ nr. 2 Bashkia Shkodër; KZAZ nr.30, 39 Bashkia Tiranë; KZAZ nr 21, nr. 24 Bashkia Durrës; KZAZ nr. 84 Bashkia Vlorë; KZAZ nr. 48 Bashkia Elbasan; KZAZ nr. 80 Bashkia Gjirokastrë,

Elbasan, e cila nuk kishte finalizuar emërimet për anëtarë të GNV-ve, deri në momentin e kryerjes së dorëzimit të kutive.

Procesi i numërimit të votave u ndesh në zvarritje të herëpashershme, të shkaktuara në disa raste nga lodhja e komisionerëve por dhe nga ndërhyrjet e vazhdueshme të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, të cilët ishin në numër të konsiderueshëm në ambientet e vendeve të numërimit. Më tej, thirrjet e vazhdueshme të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përsheptim të ritmit dhe mosndërprerje të panevojshme të procesit kontribuan pozitivisht në këtë drejtim. Përgjatë procesit të numërimit, vazhdimisht u raportua për prani të personave të paaautorizuar në ambientet e VNV-ve. Këta shtetas jo të pajisur me bexha akreditimi identifikuese ndërvepronin në mënyrë të rregullt me anëtarët e GNV-ve apo të KZAZ-së përkatëse³², duke krijuar premisa për të ndikuar në vullnetin e anëtarëve të administratës zgjedhore dhe rrjedhimisht edhe në funksionin e tyre që duhet të pasqyrojë paanshmëri dhe respektim rigoroz të ligjit zgjedhor. Procesi i numërimit të votave u mbajt në ambiente të zhurmshme dhe në çanim të masave e të protokolleve anti-Covid 19. Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore në mënyrë të vazhdueshme kanë luajtur rol proaktiv në depozitim të kontestimeve dhe situata tensioni janë krijuar në disa VNV, por me ndërhyrjen e KZAZ-së është rikthyer rendi dhe qetësia.

Gjatë monitorimit të procesit të numërimit të votave, një numër i lartë i fletëve të votimit të pavlefshme janë vlerësuar nga ana e anëtarëve të GNV-ve në VNV-të objekt monitorimi. Vlerësohet se zbatimi për herë të parë i procesit të votimit parapëlqyes për kandidatët/et, përmbajtja e fletës së votimit si dhe shtrirja e pamjaftueshme në kohë e fushatës së informimit lidhur me modelin e fletës së votimit krijuan premisa për të patur një numër të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Vëzhguesit e KSHH-së raportojnë se praktika e ndjekur për vlerësimin ose jo të pavlefshmërisë së fletës së votimit nuk reflektoi një qasje të unifikuar në disa prej VNV-ve të monitoruara.

8. Rezultati paraprak i zgjedhjeve dhe ankesat

Rezultati paraprak i zgjedhjeve sipas vendimit të KQZ-së është 74 mandate për PS-në, 59 mandate për PD-AN, 4 mandate për LSI-në dhe 3 mandate për PSD-në.

Subjektet zgjedhore kanë paraqitur në KAS një numër të konsiderueshëm ankesash duke përfshirë dhe ato me objekt: pavlefshmëri dhe përsëritje të zgjedhjeve. KAS, pas shqyrtimit të çështjeve ka konstatuar që në disa raste ka pasur shkelje të ligjit, mungesa dhe të meta të natyrave të ndryshme, por ato nuk kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve (d.m.th. në mandatet) si pasojë KAS ka refuzuar kërkesat për pavlefshmëri dhe përsëritje të zgjedhjeve. Në disa rastet, debatet dhe diskutimet mes anëtarëve të KAS janë shoqëruar me nota të ashpra, ku nuk kanë munguar dhe akuzat e ndërsjellta midis anëtarëve. Edhe në këto vendimmarrje, nuk kanë munguar ndasitë midis anëtarëve, 3 me 2, të cilat janë tregues të influencave potenciale politike tek KAS.

Aktualisht, vazhdon shqyrtimi i ankesave në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, funksional pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Deri në ditën e hartimit të këtij raporti, nga monitorimi

³² KZAZ 30, Bashkia Tiranë; KZAZ 24, Bashkia Durrës; KZAZ 50, Bashkia Elbasan; KZAZ 84, Bashkia Vlorë; KZAZ 2, Bashkia Shkodër; KZAZ 74, Bashkia Korçë; KZAZ 59, Bashkia Fier, KZAZ nr. 70 Bashkia Pogradec.

i vendimmarrjeve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe medias rezulton se janë refuzuar ankesat e depozituara për qarqet Gjirokastrë, Vlorë, Durrës, Tiranë, Shkodër dhe Korçë.

9. Sugjerime dhe Rekomandime

Në përfundim të këtij raporti monitorimi, pas evidentimit të disa prej çështjeve kyçe të cilat u trajtuan në mënyra të ndryshme nga administrata zgjedhore apo institucionet shtetërore përgjegjëse, KShH dëshiron të ndajë disa sugjerime dhe rekomandime konkrete të cilat mund të shërbejnë sadopak në zbatimin rigoroz të legjislacionit zgjedhor në të ardhmen dhe krijimin e praktikave pozitive në përputhje me parimet më të mira dhe standardet e OSBE/ODIHR-it:

9.1 Në të ardhmen do të sugjerohet që mbikqyrja dhe kontrolli i KQZ-së në të gjitha fazat e procesit zgjedhor të ushtrohet në kohën e duhur, ndërsa në shkeljet e vërtetuara të tregohet më proaktiv, i paanshëm dhe rigoroz në zbatimin e ligjit. I sugjerohet KQZ-së në rastet e sinjalizimeve të verifikuara për shkelje të ligjit zgjedhor (përfshi këtu votimin familjar, shpërdorimin e burimeve shtetërore, lejimin e qëndrimit të personave të paautorizuar brenda perimetrit të jashtëm të QV ose në brendësi të saj, etj) të zbatojë sanksionet e parashikuara në ligj. Për shkeljet e legjislacionit zgjedhor, është e rekomandueshme që KQZ të realizojë një studim përgjithësues ku të përfshihen si rastet e fazës parazgjedhore edhe ajo e votimit dhe e numërimit të votave. Kjo mendojmë se do t'i shërbejë parandalimit të shkeljeve të tilla, ndërgjegjësimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, nëpunësve të administratës publike, drejtuesve të njësive të qeverisjes vendore, subjekteve zgjedhore, etj. ndoshta edhe përmirësime të mëtejshme të legjislacionit zgjedhor në këtë fushë.

9.2 Në parandalimin e shitblerjes së votës rëndësi të veçantë ka ndërgjegjësimi i zgjedhësve por edhe veprimtaria parandaluese dhe goditëse e strukturave të policisë së shtetit, të cilat duhet të kenë efektivisht pavarësi operacionale, paanshmëri politike, integritet dhe profesionalizëm. Gjithashtu, KShH sugjeron që Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme veç njoftimeve periodike që kanë të bëjnë me denoncimet e veprave penale në fushën e zgjedhjeve (gjë që është praktikuar edhe për Zgjedhjet e 25 prillit 2021) të angazhohet në publikimin në kohë, të treguesve kryesorë që kanë rezultuar nga hetim i çështjeve të tilla. KShH mendon se kjo do t'i shërbente besimit të subjekteve zgjedhore dhe publikut si dhe reduktimit të akuzave të ndërsjellta që mund të tensiononin situatën. Hetimi, gjykimi dhe fajësia është përkatësisht kompetencë e organeve të drejtësisë penale, prokurorisë dhe gjykatës.

9.3 Sipas pikës 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, ***numri i kandidatëve në listën shumëemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i kandidatëve që do të zgjidhen në çdo zonë zgjedhore.*** Koalicioni PD AN paraqiti në KQZ listën shumëemërore për çdo zonë me më shumë kandidatë seç parashikonte ky nen, me arsyetimin se në formulimin e dispozitës së mësipërme përdoret shprehja “nuk mund të jetë më i vogël”, që do të thotë se është e drejtë e subjektit ose koalicionit zgjedhor të paraqitë më shumë kandidatë. Ky “arsyetim” nuk u pranua as nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, as nga Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS) si ankimi i subjektit dhe u rrëzua nga Kolegji Zgjedhor. Si pasojë, numri prej 222 kandidatësh në listën shumëemërore u reduktua në 153 për të 12 qarqet. Pavarësisht nga kjo, lidhur me këtë çështje KShH sugjeron që të kihet parasysh

opinion i Komisionit të Venecias dhe ODIHR-it i muajit dhjetor 2020 që rekomandon rishikimin e nenit 67 (4) të Kodit Zgjedhor pas zgjedhjeve të 25 Prillit 2021, sepse ashtu siç është formuluar neni i mësipërm mund të përbëjë një sfidë për partitë e vogla apo dhe koalicionet.

9.4 Sugjerime për për garantimin efektiv të integritetit të kandidatëve për deputetë referuar parashikimeve të ligjit për dekriminalizimin, nr. 138/2015:

- a.** Subjektet zgjedhore, me pëlqimin e kandidatëve para periudhës zgjedhore ose menjëherë pas regjistrimit të tyre në KQZ, t'i drejtohen Prokurorisë së Përgjithshme për verifikimin e kandidatëve, sidomos të atyre që në të dhënat e paraqitura kanë paqartësi.
- b.** Të bëhen ndryshime në Kodin Zgjedhor lidhur me afatet e regjistrimit të partive politike si subjekt zgjedhor dhe paraqitjen e listave shumëëmërore (nenet 65 dhe 67 të Kodit Zgjedhor). Këto afate të avancohen (ngushtohen), me qëllim që Prokurorisë së Përgjithshme t'i lihet me tepër kohë për verifikimin e kandidatëve ndaj të cilëve KQZ bën kërkesë.
- c.** Përmbajtja e formularëve të kandidatëve, sidomos në ato raste ku të dhenat janë të paqarta ose të dyshimta dhe mund të jenë subjekt të ligjit të dekriminalizimit, të bëhen publike. Kjo mund të ndihmonte institucionet e ndryshme apo individë të veçantë, në radhët e publikut të informonin për saktësinë ose jo të tyre.
- d.** Nga miratimi i Ligjit N.138/2015 kanë kaluar 5 vjet. KShH, duke ju referuar praktikës së deritanishme, do të sugjeronte gjithashtu që disa dispozita të këtij ligji të rishikoheshin.

9.5 Njoftimi i zgjedhësve në banesa - KShH, duke patur parasysh se qëllimi i ligjbërësit që ka miratuar nenin 52 të Kodit Zgjedhor, që parashikon njoftimin e zgjedhësve në banesë, synon që pjesëmarrja në votime e zgjedhësve të jetë sa më e madhe si dhe faktin se ky problem ka çaluar edhe në zgjedhjet e mëparshme, sugjeron rishikimin e nenit të mësipërm si vijon:

- a.** Fondi për këtë qëllim të akordohet jo më vonë se një muaj pas dekretimit nga Presidenti i Republikës të datës së zgjedhjeve.
- b.** Njoftimi në banesa të fillojë menjëherë pas publikimit të listës së parë të zgjedhësve dhe të vazhdojë deri në publikimin e listës përfundimtare të zgjedhësve.
- c.** Brenda 6 muajve të parë të vitit 2022, të jetë krijuar regjistri i adresave të banimit në çdo njësi administrative.
- d.** Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore të njoftojnë çdo 15 ditë KQZ-në, mbi realizimin e kësaj detyre.

9.6 Me aq sa kemi ndjekur *fushatën zgjedhore* drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet medias, tërheqin vëmendjen faktet e mëposhtme:

- a.** Të pakta kanë qënë takimet e kandidatëve të gjinisë femër, megjithëse sipas nenit 67 pika 6 të Kodit Zgjedhor për çdo zonë zgjedhore në Zgjedhjet për Kuvendin jo më pak se një në çdo tre emra duhet t'i përkasë gjinisë së nënpërfaqësuar.
- b.** Në aktivitetet e propagandës elektorale të rralla kanë qënë rastet që kanë munguar liderët e partive politike dhe rastet kur kanë folur kandidatët për deputetë.

- c. Në asnjë rast nuk është organizuar ndonjë takim elektorale për të përballur në mënyrë demokratike, kandidatë për deputetë të partive të ndryshme, me qëllim shpalosjen e programeve dhe dhënien e mundësisë medias apo publikut për të adresuar pyetje/komente. Kështu ka ndodhur edhe në zgjedhjet e kaluara. Kjo ka të bëjë me polarizimin e situatës dhe mungesën e dialogut konstruktiv.

KShH sugjeron që këto probleme të mbahen parasysh në të ardhmen, sepse një praktikë e tillë do t'i shërbente zgjedhësve edhe për pozicionimin e tyre ndaj këtij apo atij subjekti zgjedhor, madje edhe ndaj vetë kandidatit.

- 9.7 Në ndryshimet që ju bënë Kodit Zgjedhor në datë 23.07.2020 është shtuar edhe një dispozitë (**Neni 123/3**), i cili parashikon se çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë shkelje ligjore me natyrë administrative ose penale në fushën e zgjedhjeve ka të drejtë të infomojë drejtpërdrejtë KQZ-në.

KShH vlerëson se, shtetasi, për aq sa është e mundur mund të informohet (qoftë edhe në mënyrë të pranueshme) se çfarë është shkelje administrative dhe çfarë është vepër penale në fushën e zgjedhjeve. Veç kësaj e rëndësishme është që ai që dëshiron të denoncojë duhet të gëzojë të gjitha garancitë e nevojshme, lidhur me informacionin që ai mund të japë se do respektohet konfidencialiteti dhe mbrojtja e tij (zbulimi i identitetit të sinjalizuesit mund ta viktimizojë atë).

Në nenin 123/3 të Kodit Zgjedhor thuhet se të drejtat dhe interesat e personave që denoncojnë mbrohen nga legjislacioni në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. E shikojmë të nevojshme të përmendim se megjithëse ka 5 vjet që është miratuar ligji “Mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” numri i denoncimeve në shkallë vendi nga punonjës të sektorit publik dhe privat është relativisht i ulët. KShH sugjeron që KQZ-ja të mos mjaftohet vetëm me përgatitjen e modelit të denoncimit, por të miratojë udhëzime të veçantë, e autorizuar kjo nga ligji.

- 9.8 **Votimi i shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit** - KShH duke e konsideruar këtë çështje mjaft të rëndësishme që ka të bëjë me realizimin e një të drejte themelore, sugjeron rishikimin e Kodit Zgjedhor, me qëllim që të parashikojë në mënyrë të plotë dhe të qartë mundësinë e realizimit në praktikë të kësaj të drejte si dhe të konkretizojë edhe detyrat e KQZ-së. Sugjerojmë gjithashtu që të kihen parasysh mundësitë për krijimin e përshtatshëm të infrastrukturës, si dhe mënyra dhe forma e votimit që do të krijojnë besimin, jo vetëm të subjekteve zgjedhore, por edhe të vetë zgjedhësve me banim jashtë vendit. Gjithashtu, do të sugjerohet që paraprakisht të diskutohej dhe të vendosej edhe shtrirja e realizimit të kësaj të drejte, që do të thotë nëse do të kihen parasysh listat e zgjedhësve sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile që banojnë jashtë shtetit apo edhe pëlqimi i atyre që nuk figurojnë në këto lista.

9.9 Fleta e votimit dhe fletët e pavarlefshme të votimit

Duke qenë se fleta e votimit për kandidatët e subjekteve, përcaktonte numrat dhe jo emrin dhe mbiemrin e secilit kandidat, u deklarua se në dhomën e fshehtë do të vendosej një fletëpalosje ku do të pasqyrohej për çdo subjekt zgjedhor lista shumëëmërore. Në fakt, kjo

nuk u realizua. Në disa raste u vërejt që lista të tilla ishin vendosur në ambientet e brendshme ose te jashtme të qendrave të votimit.

Në këtë vështrim, KShH sugjeron që në Kodin Zgjedhor të përmendet detyrimi që fletëpalosja që përmendëm më lart të vendoset në çdo dhomë të fshehtë ku kryhet votimi.

KShH mendon se njohja me specifikimin e shkaqeve që kanë sjellë pavlefshmërinë e një pjese të fletëve të votimit ka rëndësinë e saj. Prandaj do të sugjeronim që kjo çështje, pas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, të ishte objekt diskutimi. Kjo, sipas mendimit të KShH-së mund të realizohej nëpërmjet shqyrtimit të fletëve të votimit të vlerësuara të pavlefshme nga një grup personash të ngarkuar nga KQZ-ja para afatit të asgjësimit (sipas nenit 178 pika 6 të Kodit Zgjedhor) të fletëve të votimit.

Në vazhdim të atyre që përmend më lart e shikojmë të nevojshme që në zgjedhjet e ardhshme lidhur me ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe udhëzimet përkatëse të KQZ-së të kihen parasysht edhe çështjet e mëposhtme:

8.9 KQZ-ja të udhëzojë njësitë e qeverisjes vendore dhe KZAZ-të që listat e zgjedhësve të vendosen në qendra apo institucione që do të mundësojnë zgjedhësit të njiheshin me to si në orët paradite dhe në orët e pasdites duke krijuar kështu akses efektiv të çdo zgjedhësi, përfshi edhe zgjedhësve që janë të punësuar.

8.10 Edhe praktika e zgjedhjeve të mëparshme si dhe monitorimi i zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit 2021 ka vërtetuar se njësitë e qeverisjes vendore në disa QV nuk marrin masat paraprake që ditën e votimit t'u krijohen lehtësitë e nevojshme personave me aftësi të kufizuar që e kanë vështirë lëvizjen pa ndihmesën e mjeteve përkatëse. Për realizimin e këtij detyrimi ligjor, KShH sugjeron që kryetarët e njësive të mësipërme të marrin informacionin përkatës për zgjedhës të kësaj kategorie. Vlen të theksohet se ajo që thuhet në kod që vetë ata të njoftojnë njësitë e qeverisjes, duke pasur parasysht edhe dokumentet e nevojshme, nuk është realizuar për aq sa është monitoruar nga KShH, në asnjë zgjedhje (neni 108 i Kodit Zgjedhor).

8.11 Vëzhguesit e KShH-së në takimet që kanë patur me anëtarë të KZAZ-ve kanë konstatuar që lidhur me miratimin e anëtarëve të KQV-ve nuk i kanë kushtuar vëmendje verifikimit sidomos të lidhjeve të tyre me kandidatët për deputetë të zonës zgjedhore sugjerojmë që në trajnimet e anëtarëve të KZAZ-ve dhe në udhëzimet përkatëse të KQZ-së të tërhiqet vëmendja për çështjen e mësipërme sepse kjo, siç dihet, ka të bëjë me paanshmërinë e komisionerëve.

8.12 Në nenin 7 të Kodit Zgjedhor vëzhguesve iu njihet e drejta të bëjnë vërejtje me shkrim drejtuar komisioneve zgjedhore. Kjo e drejtë iu njihet atyre shprehimisht gjatë procesit të votimit, ndërsa gjatë numërimit të votave për këtë të drejtë nuk bëhet fjalë. Do të sugjeronim që kjo të përmendej shprehimisht edhe në dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor, bazuar edhe në një nga rekomandimet e OSBE/ODIHR-it lidhur me zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 (shih Rek.nr.6).